



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 08
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 24 mars 2015, në orën 11:00.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Besa Baftiu dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan: Adem Hoxha dhe Time Kadrijaj.

Të ftuar: Arben Vitia, Shahadie Xhemaili, Merita Barani, Besa Begu, Agim Begzati, Merita Berisha, Rrahman Jasharaj, Ymer Ymeri, Nora Murataj, Jahir Lajçi dhe Blerim Delijaj.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Të ftuar grup i eksperteve të Shëndetit Oral;
3. Takim me Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës - FSSHK dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit të Kosovës – SBASHK, lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko- Social;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Të ftuar grup i eksperteve të Shëndetit Oral;

Kryetarja: “Si jemi pajtuar në mbledhjen e kaluar, sot të ftuar në Komision kemi grupin e profesionistëve të shëndetit oral dhe me këtë deshëm ta shënojmë ditën ndërkombëtare të shëndetit oral. Disa nga këta ekspertë i njoh tash një kohë të gjatë dhe e di se në baza vullnetare janë marr me shëndetin oral, por është shumë me rëndësi që ky aktivitet të përkrahet edhe nga Komuna e edhe nga Ministria. Në Ligjin për shëndetësi e kemi futur edhe shëndetin publik, por nga ju deshëm të dëgjojmë se çka mund të bëjë Komisioni në ndryshimin e Ligjit, në mënyrë që të kemi plane më afatgjata dhe që të kemi një situatë më të mirë, sa i përket shëndetit oral, si dhe nga Komisioni ynë të merrni përkrahje të vazhdueshme në punën tuaj. E dimë se shëndeti oral është shumë i rëndësishëm për shëndetin publik të popullatës, duke filluar nga shtatzënat, të cilat duhet të kenë ushqim të shëndetshëm. E dimë se shëndeti oral është shumë i rëndësishëm dhe ndikues në shëndetin e përgjithshëm dhe preventiva është më e lirë dhe më e rëndësishme sesa shërimi.

Do ja kalojë fjalën fillimisht drejtorit të Shëndetësisë së Komunës së Prishtinës”.

Arben Vitia, drejtor i drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës, i përshëndeti të pranishmit dhe tha se jemi të nderuar që na keni ftuar dhe e kuptoni rëndësinë e shëndetit publik. Si drejtori për Shëndetësi i Komunës së Prishtinës, brenda Ligjit për Shëndetësi merremi me kujdesin primar shëndetësor, por në masë të madhe kujdesi primar shëndetësor duhet të merret me edukimin dhe promovimin shëndetësor. Por asnjë komunë nuk mund ti bëjë të gjitha vet pa përkrahjen e institucioneve tjera. Komuna jonë, vitin e kaluar ka filluar aktivitetin e ekzaminimeve sistematike të fëmijëve të klasave të para dhe të pesta, ku janë vizituar rreth 7 mijë nxënës. Pas përfundimit të vizitave më shqetësuesja në shëndetin e fëmijëve ka qenë shëndeti oral. Në klasat e para rreth 89% e fëmijëve kanë pasur karies, ndërsa të klasat e pesta rreth 82%. Në bazë të kësaj kemi filluar disa aktivitete promovuese për shëndetin oral. Duke i parë këto rezultate shërbimi stomatologjik i Qendrës së Mjekësisë Familjare, ka ndërmarrë një mori masash të promovimit, edukimit në institucione shkollore por edhe të prindërve që kjo situatë e shëndetit oral të fëmijëve tonë të përmirësohet. Janë publikuar edhe disa broshura me informata, duke filluar nga gratë shtatzëna, për fëmijët, për ushqimin e nevojshëm por edhe me shërbimet stomatologjike që ofrohen në QKMF Prishtinë.

Këtë vit do të hapen edhe tri ordinaanca të reja stomatologjike, ku dy prej tyre do të merren ekskluzivisht me promovimin dhe parandalimin e sëmundjeve dhe me higjienën orale.

Për herë të parë, fal edhe donatorëve, kemi shënuar ditën ndërkombëtare të shëndetit oral, ku me aktivitete të ndryshme mendojmë se kemi arritur edhe rezultate të mira. Ja shpërnda rreth 28.000 broshura me informata të rëndësishme të shëndetit oral, por kemi pas edhe shumë emisione televizive me informata të rëndësishme për këtë çështje. I gjithë ky aktivitet ka rezultuar me sukses por nuk është i mjaftueshëm dhe duhet më shumë të angazhohemi që të kemi rezultate të plota, theksoi Vitia.

Kemi në plan që gjatë këtij viti të fillojmë edhe me botimin e një reviste shëndetësore, e cila do të ketë informacione të mjaftueshme për shëndetin. Kemi hapur edhe ueb faqen e mjekësisë familjare në komunën e Prishtinës. Me të gjitha këto aktivitete kemi për qëllim që të arrijmë disa objektiva në përmirësimin e shëndetit oral të popullatës së shtatzënave të fëmijëve.

Sa i përket bazës ligjore, shtoi Vitia, ekziston një bazë e mirë ligjore sa i përket shëndetit publik, por mendoj se ka munguar bashkëpunimi dhe koordinimi në mes të komunave, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik. E mirëpresim angazhimin e Komisionit Parlamentar që bashkëpunimi të jetë në një nivel më të lartë, në mënyrë që shëndeti publik të jetë më i mirë, tha Vitia.

Kryetarja: “ Ja kaloj fjalën njëërës prej eksperteve, e cila ka punuar me fëmijët në Qendrën e Fëmijëve Bonjak, ku ka bërë edhe një hulumtim për shëndetin oral të këtyre fëmijëve znj. Besa Begu, dhe kërkoj që të kemi edhe propozime konkrete për përmirësim të shëndetit oral. Gjithashtu kërkoj që edhe profesori i Fakultetit të Stomatologjisë z. Agim Begzati ta jap kontributin e vet me paraqitjen e propozimeve konkrete për përmirësimin e shëndetit oral.

Agim Begzati tha se në Qendrën Klinike Stomatologjike të Kosovës ekziston grupi për promovim të shëndetit oral, i cili e ka pasur si prioritet të bëj studimin e gjendjes orale te fëmijët. Duke qenë se programet preventive nuk mund të ndërmerren pa pasur një pasqyrë se si është gjendja shëndetësore endorale te fëmijët tanë, ne kemi bërë disa studime. Të dhënat e studimit kanë treguar se gjendja e shëndetit oral te fëmijët tonë është alarmante. Sipas studimeve të bëra del se diku rreth 80% e fëmijëve kanë karies, përkatësisht 7 deri 9 dhemb te një fëmijë janë me karies. Kjo tregon se shëndeti oral te fëmijët është në nivel të ultë.

Edhe masat preventive nuk japin rezultat të shpejta . Te gjitha këto masa dhe hulumtime janë më shumë individuale dhe kjo problematikë kërkon një shtrirje kombëtare dhe një strategji shtetërore. Edukimi shëndetësor duhet të fillojë në shkolla dhe të vazhdojë edhe në institucionet tjera.

Na duhen projekte afatgjate të përmirësimit të shëndetit oral në mënyrë që të arrijmë edhe rezultate afatgjata, theksoi Begzati.

Besa Begu theksoi se si magjistre e shëndetit oral kam një eksperiencë sa i përket shëndetit oral në Kosovë. Kam bërë edhe dy studime sa i përket gjendjes së shëndetit oral. Njëri studim ka pasur për temë se sa studentët punojnë me stomatologji preventive dhe aty del se studentët merren me trajtime emergjente, pasi klinika mbingarkohet me raste akute dhe nuk merren me stomatologji preventive. Kjo paraqet një problem që duhet të zgjidhet.

Sa më shpejt brenda Klinikës së Stomatologjisë duhet të ketë një Klinik të Stomatologjisë Preventive.

Pasi kemi një gjendje të rëndë të shëndetit oral, kisha një propozim për futjen e shpëlarjes së florit në shkolla, edhe pse është një metodë e kushtueshme, është një metodë e suksesshme dhe me rezultate pozitive. Duhet të ndërmarrën hapa më serioz, sidomos në çerdhe dhe shkolla që të përmirësohet shëndeti oral. Mund të marrim edhe disa praktika të mira nga shteti i Suedisë ku edhe kam studiuar, tha Begu.

Shahadie Xhemaili falënderoi për bashkëbisedimin dhe tha se si specialiste e shëndetit oral, jam pjesë e ekipit të specialistëve që kanë bërë vizitat sistematike në shkollat dhe çerdhet e Prishtinës. Gjatë vizitave ne e kemi prek problemin dhe gjendja ka qenë shqetësuese, dhe kjo është pasojë e shumë faktorëve.

Si QKMF në Prishtinë, me kushtet që na janë ofruar kohën e fundit mendojmë se do të bëjmë përmirësim të situatës dhe qëllimi jonë është të krijojmë një kulturë që fëmijët të shkojnë te stomatologu dhe prindërit të jenë më të kujdesshëm.

Me shënimin e ditës botërore të shëndetit oral, mendojmë se mesazhi ka arritur ku ne kemi dashur. Për të pasur dhembë të shëndosh, duhet të kemi edhe ushqim të shëndetshëm. Duhet të gjithë të japim kontribut, dhe të na mbështesni që bashkërisht të arrijmë rezultate, tha Xhemaili.

Meriat Barani tha se tani fokusi i Drejtorisë për Shëndetësi të Komunës së Prishtinës është te stomatologjia primare. Pas vizitave sistematike që kemi kryer vitin e kaluar, kemi bërë edhe një

projekt, ku përveç hulumtimeve që kemi bërë në kopshtet publike , ka qenë edhe promovimi dhe informimi. Gjithashtu fëmijëve të kopshteve publike u është hapur një kartelë dentare, si mesazh për prindërit e tyre dhe rezultatet kanë qenë të kënaqshme.

Gjatë shënimit të ditës botërore të shëndetit oral kemi bërë promovim të suksesshëm bashkë me donatorët që na kanë mbështetur.

Pas gjithë këtyre aktivitete, ne e kemi parë të arsyeshme ta zhvillojmë edhe një projekt, që kur të regjistrohen fëmijët në shkolla fillore ta kenë një lloj karte, si ajo e imunizimit, të jetë pasqyrë e dhëmbëve të fëmijës.

Por prapë së prapë projektet afatshkurta nuk janë të suksesshme, duhet të kemi projekte afatgjata. Jemi në bashkëpunim edhe me OBSH-në që ta bëjmë promovimin e shëndetit oral edhe te nënat qysh gjatë shtatzënisë e pastaj gjatë gjithë procesit.

Ju informoj se ekziston edhe Komiteti Ndërmintor për shkolla promovuese të shëndetit, ku ndoshta ju si përfaqësues të popullit mund të shtyni ndonjë projekt afatgjatë për shëndetin oral, theksoi Berani.

Merita Berisha tha se punoj në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe shtoi se për vendin tonë është e rëndësishme ta themi se kariesi është problem socialo-mjekësor. Ekspertët e shëndetësisë publike e shohin problemin në tri aspekte; në atë profesional, shkencor dhe edukativo arsimor. Ne bëjmë analizën e sëmundjeve në disa aspekte. Kariesi përveç që në dimension është mjaft i shtrirë, edhe individualisht e afekton individin, sidomos fëmijët, ju shkakton shumë probleme shëndetësore , por ka edhe konotacione financiare për familjen.

Kariesi ka interaksion që ndërlidh individin me rrethin e ngushtë të tij, por edhe me rrethin e gjerë të ti.

Sa i përket veprimeve tona, pasi është një problem i shëndetësisë publike, duhet të fillojë me masat e preventivës primare, masat e preventivës sekondare dhe të asaj terciare. Pra, duhet ta mbulojmë tërë ciklin jetësor qysh para shtatzënisë së nënës, gjatë shtatzënisë, me lindjen dhe rritjen e fëmijës dhe gjatë gjithë jetës. Kemi masa që i drejtohen individit dhe masa të cilat i drejtohen popullatës. Pra shteti mund të ndërmerri masa të cilat do të ndikojnë pozitivisht te individit. Masat e ndërmarra përmes informimit, florizimit të ujit, apo masa tjera do të ndikojnë në parandalimin e kariesit, dhe këto janë masa të ndërmarra në popullatë. Kemi edhe masa që ndërmerren në individin, në çfarëdo forme.

Meqenëse në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike ekziston një komision për edukim shëndetësor, i cili ka kontribuar në fushatën e shëndetit oral dhe është duke përgatitur një strategji për promovim dhe edukim shëndetësor, kisha kërkuar të na mbështetni në financimin e projekteve të këtij komisioni, në mënyrë që ne të ofrojmë mjekësi të bazuar në fakte. Vetëm nëse ne i kemi evidencat e sakta për situatën epidemiologjike, atëherë ne mund të veprojmë me masa. Nëse dëshirojmë ta adresojmë problemin e kariesit, atëherë ne duhet të intervenojmë në disa aspekte, edhe në aspektin legjislativ, edhe programe me masa të veprimit, edhe ne aspektin e resurseve njerëzore. Metodat dhe mjetet edukative dhe arsimore dallojnë, prandaj duhet që masat të jenë të veçanta.

Kryetarja pyeti të ftuarit se a ka një plan kombëtar për preventivë kundër kariesit dhe sëmundjeve të tjera ?

Merita Berisha tha se kemi një strategji 2014 – 2020, në bazë të të cilës është hartuar edhe plani i veprimit, ku i është dhënë një hapësirë mjaft e madhe edhe kujdesit parësor shëndetësor. Brenda kësaj strategjie është edhe komponenti i shëndetit oral. Shëndeti oral është edhe në agjendat e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik.

Agim Begzadi theksoi se ekziston një program strategjik, por mundësia e veprimit është e kufizuar. Nëse dëshirojmë të kemi programe afatgjate dhe ndryshime rrënjësore të gjendjes, duhet të kemi qasje më serioze dhe duhet të kemi një Qendër Kombëtare për Shëndetin Oral. Metodat e florizimit janë të mira dhe nuk janë shumë të shtrenjta, pra florizimi si metodë preventive është e mirë, tha Begzadi.

Njomza Emini përgëzoi drejtorinë e Komunës së Prishtinës për punën e bërë sa i përket shëndetit oral të fëmijëve.

Mendoj shtoi ajo se është momenti i fundit për tu angazhuar të gjithë që të merren masa efikase për luftën kundër kariesit.

Ju e theksuat se gjendja është alarmante dhe mendoj se kanë ndikuar shumë faktorë, ndonjëherë mungon edhe vetëdijesimi, por te një pjesë e madhe ka edhe vështirësi ekonomike dhe shërimi i kariesit ka kosto. Më pëlqej ideja e zonjës Besë, për hapjen e një ordinance për këshilla për shëndetin oral. Edhe ideja për një revistë shëndetësore në shkolla është e mirë sepse në librat ekzistues të edukatës qytetare nuk flitet shumë apo fare për shëndetin oral. Gjithashtu duhet të ketë edhe emisione televizive për edukimin e shëndetit oral.

Kërkoj nga ju që t'na drejtoheni me rekomandime konkrete dhe ne do ta trajtojmë problematikën edhe me Ministrin e Shëndetësisë. Kjo problematik duhet të trajtohet në nivel kombëtar, sepse në vendet rurale gjendja është edhe më e vështirë, theksoi Emini.

Besa Baftiu pasi falënderoi për informacionet e sakta të ofruara, shtoi se u njoftuam për një gjendje kaq të rëndë të shëndetit oral në Prishtinë, e që në komuna të tjera gjendja mund të jetë edhe më e rëndë. U pa nga diskutimi se është një bashkëpunim në mes të Drejtorisë për Shëndetësi të Komunës së Prishtinës, Fakultetit të Stomatologjisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, por po mungon kahu i njërit trekëndësh, që është Ministria e Shëndetësisë, dhe që është kompetente për hartimin e programit nacional në nivel vendi.

Mendoj se Ministria e Arsimit duhet të fut si lëndë të veçantë edukatën shëndetësore. Besoj se me punë të përbashkët të arrini rezultate që fëmijët tanë të jenë fëmijë të shëndetshëm.

Shukrije Bytyçi theksoi se rëndësia e një dhëmbi të shëndosh është prioritet për një trup të shëndosh, dhe për këtë edhe Fakulteti i Stomatologjisë është i veçantë nga Fakulteti i Mjekësisë. Fatkeqësisht në masën e duhur nuk e dimë rëndësinë e dhëmbit të shëndosh dhe pasojat si dëgjuam janë alarmante. Pyes se cili është bashkëpunimi në mes të Fakultetit të Stomatologjisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, sepse të gjithë e dimë se është më mirë dhe më lehtë të parandalohet sëmundja sesa të shërohet.

Kryetarja tha se shëndeti oral është shumë i rëndësishëm dhe u pa edhe nevoja e intervenimit të deputetëve në luftën kundër kariesit. Pra kariesi mund të luftohet edhe politikisht edhe profesionalisht. Ne do të bashkëpunojmë dhe kontribuojmë që gjendja në shëndetin oral të përmirësohet.

3. Takim me Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës - FSSHK dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit të Kosovës – SBASHK, lidhur me monitorimin e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko - Social;

Kryetarja përshëndeti përfaqësuesit e sindikatave për gatishmërinë për t'ju përgjigjur ftesës së Komisionit. Ajo i njoftoi se Komisioni është duke e bërë monitorimin e Ligjit për Këshillin Ekonomiko Social dhe se kanë realizuar disa vizita në terren.

Nga vizitat në terren, tha ajo, kemi parë se ju si dy sindikata shumë të rëndësishme, nuk jeni pjesë apo nuk jeni të përfaqësuara në Këshillin Ekonomiko Social. Kërkojmë nga ju të na njoftoni se a jeni të përfaqësuara në KES .

Blerim Delijaj tha se ne si sindikatë e shëndetësisë nuk jemi fare të përfaqësuar në KES. Ne nuk jemi aty ku është prezent ministri i shëndetësisë dhe ku shqyrtohen dhe vendoset për problemet ekonomik e sociale të anëtarësisë sonë. Kemi bërë kërkesë që zyrtarisht të jemi pjesë e KES-it, dhe e dimë që kemi pas të drejt ligjore që të jemi pjesë e KES-it. Kjo na është pamundësuar me arsyetim se vetëm pse nuk jemi konfederatë, nuk mund të jemi pjesë e KES-it. Ne i përfshijmë në sindikatën tonë 95% të të punësuarve në shëndetësi, dhe të gjithë i plotësojmë kushtet e parapara me ligj për kartelat e anëtarësisë dhe të gjitha kushtet tjera.

Në KES janë të përfaqësuara sindikatat që nuk ekzistojnë. Kemi informacion se një komision ka punuar dhe ka verifikuar dokumentacionin, por ne mendojmë se BSPK-ja nuk mund të na përfaqësojë sepse nuk i plotësojnë kushtet ligjore për konfederatë, dhe se nuk kanë as numrin e nevojshëm të anëtarësisë. Kërkojmë nga Komisioni, që kërkesat dhe brengat tona ti përkrah dhe ti përcjell, edhe pse ne i kemi paraqitur edhe te ministri Arban Abrashi. Kemi marr garanci nga ministri Abrashi se shumë shpejt do të ndryshohet edhe Ligji për Këshillin Ekonomiko Social.

Rrahman Jasharaj tha se Sindikata e Bashkuar e Arsimit dhe Shkencës, me rastin e konkursit të hapur për të qenë pjesë e KES-it, ka konkurruar dhe i ka ofruar dokumentet e kërkuara, si për anëtarësinë ashtu edhe për anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Gjithashtu ne kemi paraqitur edhe ankesën tonë sa i përket komisionit për verifikimin e dokumentacionit për anëtar të KES – it, dhe e kemi vlerësuar si komision që bie ndesh me vetveten sepse ka bërë vlerësimin e vetvetes.

Gjithashtu BSPK-ja, nuk ka anëtarësinë e kërkuar me ligj dhe nuk mund të jetë përfaqësues i vetëm në KES. Kërkoj nga ju që ligji për KES-in të amendamentohet dhe të hiqet kriteri që duhet të jemi konfederatë.

Po ua paraqes edhe një shqetësim të madh të sindikatës sonë, se edhe pse kemi negociuar tash një kohë të gjatë dhe kemi bërë shumë lëshime në kërkesat tona, prapë kërkesa jonë e vetme e që u deklarua se do të përmbushet sa i përket stazhit të punës, nuk po përmbushet, kështu që Qeveria me veprimet e veta po e dërgon SBASHK-un përsëri në grevë.

Apeloj që të angazhoheni dhe ta bëni ndryshimin e Ligjit për Këshillin Ekonomiko Social.

Hatim Baxhaku tha se kam një pyetje edhe pse ndoshta nuk kam shumë njohuri për problematikën e cekur. Kush e përfaqëson në KES, Sindikatën e Arsimit dhe të Shëndetësisë? A ju përfaqëson BSPK-ja, apo ndonjë sindikatë tjetër?

Rrahman Jasharaj tha se vetëm BSPK-ja është e përfaqësuar në KES, me pesë anëtarë. Ne të tjerët nuk jemi fare anëtarë të KES-it.

Blerim Delijaj – Federata e Sindikatës së Shëndetësisë së Kosovës ju thash përfshin 95% të mjekëve të Kosovës dhe BSPK apo asnjë sindikatë tjetër nuk mund ti përfaqëson mjekët e Kosovës.

Flora Brovina – Cila ka qenë përgjigja e ministrisë në konkurrimin tuaj ?

Blerim Delijaj tha se përgjigja ka qenë se ne nuk i kemi plotësuar kriteret sipas Ligjit për shkak se duhet me qenë 10% e të të gjithë të punësuarve në nivel të Kosovës pjesë e Konfederatës, ndërsa në Ligj askund nuk përmendet konfederata. Ne dy sindikatat e pranishme e përbëjmë mbi 15% të të punësuarve në nivel të Republikës së Kosovës, anëtarë të regjistruar dhe me

deklarata të anëtarësisë, ndërsa BSPK-ja e përfshin vetëm 1% të të punësuarve në nivel të Kosovës. Ministria e Punës e ka parë si antiligjore që ne të përfaqësohemi në KES.

Nora Murataj sqaroi paraprakisht, se katër sindikatat arsimit, shëndetësia , judikatura dhe policia, kanë nënshkruar një memorandum të bashkëpunimit dhe përfaqësimit të përbashkët në KES, dhe këtë tha ajo, ja kemi deponuar edhe komisionit për përfaqësim në KES, por komisioni nuk e ka marr parasysh. Përgjigja ka qenë përmes e-mailit se ju refuzohet përfaqësimi në KES.

Ymer Ymeri theksoi se kur kemi dëgjuar se është formuar Komisioni për përzgjedhjen e anëtarëve të KES-it, si sindikatë e arsimit kemi reaguar për keqpërdorimet që janë bërë në propozimin e natarëve të Komisionit përzgjedhës. Në Komision ka qenë i përfshirë nënkryetari i BSPK-së dhe ka qenë një konflikt interesi që të jetë i përfshirë në Komision vlerësues vet aplikuesi, ndërsa ne si dy sindikata na kanë përjashtuar. Reagim i yni ka qenë që BSPK-ja nuk i plotëson kushtet ligjore për anëtarësi, 10% të të gjithë të punësuarve në nivel të Kosovës. Konsiderojmë se ka një mostransparencë të madhe brenda KES-it, lidhur me punën e tyre, dhe të komisioneve të KES-it. Si pasojë e kësaj mostransparence dhe e mospërfaqësimit tonë në KES, vije edhe deri te mospajtimet dhe te organizimi i grevave.

Kryetarja: “Si i adresoni ju kërkesat tuaja”?

Rrahman Jasharaj tha se kërkesat tona ja adresojmë ministrit të Arsimit, por shpesh ndodh që kërkesat tona mbesin brenda MASHT-it , dhe shumë herë MASHT-i nuk ka buxhet t’i përmbush kërkesat tona, ndërsa po të jemi pjesë e KES-it, kërkesat tona do të adresoheshin deri te Qeveria.

Blerim Delijaj theksoi se kërkesat e kontratës sektoriale i zgjidhim me ministrin tonë dhe kemi bashkëpunim të mirë, ndërsa kërkesat e kontratës së përgjithshme, nuk kemi rrugë tjetër vetëm përmes KES-it, apo protestave.

Shukrije Bytyçi tha se sindikatat janë mbrojtëse të punëtorëve të tyre, dhe sot keni ardhur për KES, por më intereson të di se sa është përfshirja e punëtorëve të arsimit në sindikatën tuaj ?

Rrahman Jasharaj tha se ne e kemi kaluar numrin prej 20.000 anëtarëve të sindikatës sonë dhe çdo muaj kemi ngritje të anëtarësisë. Rreth 90% të mësimdhënësve janë pjesë e SBASHK-ut.

Shukrije Bytyçi tha se në shkollën ku unë punoj, vetëm 1 (një) punëtor është pjesë e sindikatës, ndërsa nuk kemi përvojë të mirë me sindikatën sepse ka ndodh që vet sindikata e thirrur grevën, e pastaj vet e kanë thyer grevën.

Rrahman Jasharaj theksoi se kjo ka ndodh, por tani kemi ndryshime edhe në SBASHK, dhe situata është më e mirë edhe në mbrojtjen e të drejtave të anëtarësisë.

Kryetarja i falënderoi të ftuarit për kontributin duke garantuar se kërkesat e tyre do të adresohen.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA